



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
PROKURORIA THEMELORE / OSNOVNO TUŽILAŠTVO / BASIC PROSECUTION
PRIZREN – PRIZREN

AD.nr. 2/25
Dt. 18.02.2025
Prizren

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, duke vendosur lidhur me çështjen disiplinore të iniciuar pas pranimit të ankesës së avokates [REDACTED], avokate nga [REDACTED], kundër prokurores së Prokurorisë Themelore në Prizren, [REDACTED] [REDACTED] në bazë të nenit 9 par.1 pika 1.5 dhe par.6 të Ligjit Nr. 06/L – 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 par.3 nënpar.3.1 të Rregullores nr. 05.2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e avokates [REDACTED], avokate nga [REDACTED], kundër prokurores së Prokurorisë Themelore në Prizren, [REDACTED] [REDACTED], sepse nuk ekziston asnjë nga shkeljet disiplinore nga neni 6 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L – 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Më datë 12.02.2025 përmes Këshillit Prokurorial të Kosovës, Autoriteti Kompetent ka pranuar një parashtrësë të trajtuar si ankesë nga avokat [REDACTED] nga [REDACTED] ndaj prokurores së Prokurorisë Themelore të Prizrenit nga Departamenti për të Mitur, znj. [REDACTED]
[REDACTED]

Dyshimet e para për shkelje disiplinore:

Dyshimet e para sipas parashtruesit në ankesës, janë pretendimet se prokurorja e Departamentit për të Mitur, [REDAKTUAR], është duke punuar kundërligjshëm dhe nuk është duke i ndërmarre veprimet parandaluese në çështjen e pretenduar penale të marrjes apo mbajtjes së kundërligjshme të fëmijës nga e pandehura [REDAKTUAR].

Për më tepër, avokatja në mënyrë decisive në shkresën e saj pretendon se “*procedura vazhdon me zvarritje të madhe*”. Gjithashtu, pretendohet se pasi ishte vendosur e pandehura së bashku me fëmijën e saj në shtëpinë e sigurte – në strehimore, për arsye të panjohura, më datë 02.02.2025, me urdhër të prokurores është liruar [REDAKTUAR] me fëmijën e saj të mitur – vajzën 4 vjeçare [REDAKTUAR] dhe në vend që e pandehura të kthehet në shtëpinë e bashkëshortit të saj, është kthyer në shtëpinë e prindërve të saj. Për fund, është kërkuar të ndërmerren veprimet parandaluese në kohë!

Pasi që kemi pranuar këtë shkresë të njëjtën e kemi regjistruar në regjistrin e procedurave disiplinore dhe ka marrë numrin AD.nr.2/2025, për rastin në fjalë sipas procedurave është njoftuar Këshilli Prokurorial i Kosovës, përkatësisht kryesuesi i KPK-së, z. [REDAKTUAR].

Veprimet e Autoritetit Kompetent:

Më datë 13.02.2025, është njoftuar Këshilli Prokurorial i Kosovës lidhur me regjistrimin dhe trajtimin e ankesës disiplinore.

Më datë 13.02.2025, Kryeprokurori, konform nenit 6 par.4 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, ka kërkuar deklaratë lidhur me pretendimet në fjalë nga prokurorja [REDAKTUAR].

Më datë 14.02.2025, kam pranuar deklaratën me shkrim nga prokurorja [REDAKTUAR].

Më datë 14.02.2025, kam pranuar shënimin zyrtar nga Qendra për Punë Sociale në Prizren, duke përfshirë bashkëngjitjen e procesverbaleve të marrjes në pyetje lidhur me gatishmërinë e marrjes së kujdesit nga familjarët për të pandehurën dhe vajzën e saj.

Të gjeturat e rastit disiplinor:

Paraqitësja, avokate [REDAKTUAR], lidhur me këtë çështje ka dorëzuar edhe më parë parashtrësë për këtë çështje, më datë 05.02.2025, ku Autoriteti Kompetent e ka pranuar kërkesën lidhur me sqarimin e çështjes penale nën shenjë [REDAKTUAR], në të cilën është pretenduar se lënda

nuk është duke u trajtuar si duhet nga prokuroria, në drejtim të ndërmarrjes së masave parandaluese për evitim të keqpërdorimit të serishëm të fëmiut për shkak të lirim të strehimorja.

Lidhur me këtë kërkesë, Autoriteti Kompetent ka kërkuar sqarime lidhur me rastin nga prokurori i çështjes dhe ka analizuar edhe personalisht çështjen në fjalë dhe më datë 07.02.2025, është njoftuar avokatja me detajet e lëndës.

Sqarimet e prokurorit të çështjes:

Nga përgjigja e prokurores së çështjes vërtetohet që e njëjta ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme procedurale në kohë. Gjatë zhvillimit të hetimeve dhe marrjes së deklaratave të palëve, prokurorja ka gjetur se ekzistojnë elementet e veprës penale “*marrja apo mbajtja e kundërligjshme e fëmijës*” nga neni 242 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës për çka edhe më datë 12.02.2025 ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurës [REDAKTUAR] pranë Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për të Mitur për veprën e lartcekur.

Prokurorja, ka sqaruar gjithashtu se ka vlerësuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës, po ashtu edhe deklaratën e palëve në procedurë mirëpo nuk ka arritur të gjejë elemente të ndonjë veprë tjetër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare apo të involvimit të ndonjë personi tjetër në rast.

Sa i përket pretendimeve se e dyshuara [REDAKTUAR] me urdhër të prokurores së rastit është vendosur në shtëpinë e sigurte së bashku me vajzën, prokurorja ka sqaruar se një gjë e tillë nuk qëndron, pasi që më datë 14.01.2025 rreth orës 22:00^{min} në stacion policor kur është paraqitur [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], dhe vajza e tyre [REDAKTUAR], e dyshuara është intervistuar nga zyrtarët policor dhe është dërguar së bashku me vajzën në strehimore deri në marrjen e një vendimi tjetër, vlen të theksohet se në këtë datë prokurorja e çështjes nuk ka qenë kujdestar dhe se paraqitja në stacion policor ka ndodhur pas orarit të rregullt të punës.

Po ashtu, se e dyshuara së bashku me vajzën më datë 02.02.2025 është liruar nga strehimorja, prokurorja ka sqaruar se në asnjë fazë të procedurës nuk ka dhënë udhëzime në lidhje me kompetencat e QPS-së, për ta pranuar ose liruar nga Strehimorja, pasi që një gjë e tillë nuk është në tagrin e prokurorisë për të vendosur.

Gjendja faktike:

Autoriteti Kompetent, ka vërtetuar se lidhur me këtë çështje penale, më datë 23.10.2024 është pranuar raport njoftues nga Policia e Kosovës se më datë 18.10.2024 në stacion policor është paraqitur i dëmtuari [REDAKTUAR] duke deklaruar se bashkëshortja e tij [REDAKTUAR] është larguar nga shtëpia së bashku me vajzën e tyre 4 vjeçe.

Më datë 24.10.2024 prokurori i çështjes ka pranuar Raportin Informues, kurse më datë 28.10.2024 ka lëshuar autorizim për hetim dhe mbledhjen e të dhënave me numër [REDAKTUAR]

Më datë 01.11.2024 prokurori ka lëshuar kërkesë për identifikimin e abonentit të operatorit të telefonisë mobile [REDAKTUAR] për numrin [REDAKTUAR] në shfrytëzim nga ana e të dyshuarës.

Më datë 05.11.2024 ka lëshuar urdhëresë për masa të veçanta hetimore - regjistrimi i thirrjeve telefonike dhe atë duke potencuar urgjencën e rastit.

Më datë 15.11.2024 ka pranuar Raportin informues nga policia - operatori përgjegjës [REDAKTUAR] ku prokuroria është njoftuar se numri [REDAKTUAR] nuk është aktiv.

Më datë 21.01.2025 është pranuar kallëzimi penal nga policia [REDAKTUAR] kundër të dyshuarës [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale *"marrja apo mbajtja e kundërligjshme e fëmijës"* nga neni 242 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datë 05.02.2024 në lëndën nën shenjë [REDAKTUAR], prokurori i çështjes ka filluar hetimet ndaj të pandehurës [REDAKTUAR] për shkak të dyshimit të arsyeshëm se është përfshirë në kryerje të veprës penale *"marrja apo mbajtja e kundërligjshme e fëmijës"* nga neni 242 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datë 05.02.2024 është marrë në pyetje e pandehura [REDAKTUAR] në prokurori, në prezencën e mbrojtësit të caktuar sipas detyrës zyrtare av. [REDAKTUAR] dhe po ashtu në prezencën avokates [REDAKTUAR] si përfaqësuese e autorizuar e të dëmtuarit [REDAKTUAR]!

Më datë 07.02.2025 është ftuar në prokurori përfaqësuesja e palës së dëmtuar avokate [REDAKTUAR] dhe i dëmtuari, për dëgjim të palëve në procedurë, duke mos lënë hapësirë për neglizhencë në trajtimin e kësaj çështjeje, përkundrazi!

Kurse sa i përket asaj se e dyshuara [REDAKTUAR] me urdhër të prokurores është liruar nga strehimorja, është vërtetuar se prokurorja e çështjes në asnjë fazë të procedurës nuk ka dhënë udhëzime në lidhje me kompetencat e QPS-së, për ta pranuar ose liruar nga shtëpia e sigurve - strehimorja të njëjtën, pasi që kjo është e drejtë ekskluzive e QPS-së, e jo e prokurorit të shtetit.

Lidhur me këtë çështje, AK ka siguruar shënimin zyrtar nga QPS në Prizren, dërguar nga [REDAKTUAR], drejtoreshë e QPS, e cila sqaron se mënyrën e pranimin dhe qëndrimin në strehimore të të pandehurës [REDAKTUAR] dhe vajzës së saj, deri më datë 03.02.2025 kur prindërit e [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], janë paraqitur dhe kanë deklaruar në QPS, se dëshirojnë që ta marrin vajzën e tyre së bashku me mbesën dhe kanë pohuar që do të kujdesen që mos të largohen nga shtëpia, gjithashtu edhe e pandehura ka deklaruar në strehimore se dëshiron të largohet nga strehimorja dhe të shkon te familja e saj në fshatin [REDAKTUAR]. Së bashku me këtë shënim zyrtar si provë kanë bashkëngjitur edhe deklaratat e palëve, gjë e cila demanton në tërësi pretendimin e avokates në parashtresë.

Ajo që vlen për t'u theksuar është fakti se [REDAKTUAR] për prokurorinë që nga fillimi është trajtuar si e dyshuar dhe tani vazhdon të trajtohet si e pandehur, në këtë drejtim QPS-ja së bashku me strehimoren kanë mundur ta vlerësojnë se a mund të mbahet një person me cilësimin *"e pandehur"* në strehimore dhe kjo çështje nuk prek aspak në kompetencat e prokurorit të shtetit.

Është me rëndësi të konstatohet fakti se hetimet në këtë çështje penale, e trajtuar nën shenjë [REDAKTUAR], kanë filluar më datë 05.02.2025 dhe kanë përfunduar me ngritje të aktakuzës më datë 12.02.2025. Siç mund të shihet dhe konstatohet, kjo çështje penale është trajtuar me shumë prioritet duke ndërmarrë veprime hetimore në afat rekord dhe duke i dhënë epilog përfundimtar çështjes *brena 7 (shtatë) ditësh*. Në këtë situatë dhe gjendje faktike para vetes, çfarë përgjigje mund t'i jepet konstatimit në parashtresë se "*procedura vazhdon me zvarritje të madhe*"?!

Nga të lartcekurat, vlerësojmë se rasti është trajtuar me prioritet dhe konform procedurave ligjore dhe se prokurorja e çështjes ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore procedurale.

Konkluzioni:

Kryeprokurori si autoritet kompetent, nga të lartcekurat, pas vlerësimit dhe elaborimit në detaje si më lartë, si dhe pas analizimit të kësaj çështjeje disiplinore, nga deklarata e prokurorit të lartcekur, në veçanti nga shkresat e lëndës, kryeprokurori ka konstatuar dhe vendosur se në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga shkeljet disiplinore nga neni 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, pasi që në bazë të shkresave të kësaj lënde konstatohet se prokurori i rastit i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme dhe të domosdoshme ligjore konform dispozitave ligjore në fuqi dhe të gjitha veprimet e prokurorit kanë qenë profesionale dhe ligjore dhe në kuadër të fushëveprimtarisë funksionale dhe profesionale të prokurorit të shtetit, duke mos rënë ndesh për asnjë moment me kodin etik dhe sjelljen e pahijshme të prokurorit të shtetit.

...

Me sa u cek më lart u vendos si në dispozitiv të vendimit.

T'i dorëzohet:

- [REDAKTUAR]
- [REDAKTUAR]
- Arkivës.

KRYEPROKURORI

